



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Qershor 2021

Nr. 405

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Areti Beruka, me funksion Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë
- Kërkues:** Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- Ndaj:** Zj. Areti Beruka, me funksion Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak



Data: 18 Qershor 2021
Nr. 405

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Areti Beruka, me funksion Kryeinspektor i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1382 prot., datë 19.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3985 prot., datë 19.04.2021, nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm zj. Ornela Zonja, është përcjellë denoncimi i mbërritur në mënyrë shkresore pranë këtij institucioni nga z. Bashkim Molla. Në këtë denoncim pretendohet se: *“Zj. Beruka, aktualisht Inspektore në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, prej kohësh ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep posti i vet duke shfrytëzuar makinat e institucionit për fushatë si dhe duke kërcënuar qytetarët të votojnë për subjektin politik Partinë Socialiste. Qytetari bën me dije se ndihet i rrezikuar nga kërcënimet e zj. Beruka dhe kërkon ndihmë në organet ligjzbatuese.”*

Denoncuesi kërkon verifikimin dhe hetimin e rastit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.



Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, datës së kallzimit dhe ndalimeve të parashikuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallzuesi, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Përsa i përket pretendimit të denoncuesit se zj. Beruka ka kërcënuar qytetarët të votojnë për subjektin politik Partinë Socialiste, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se hetimi për këto të dhëna del jashtë kompetencës së tij lëndore dhe vendos të shpallë moskompetencën në lidhje me këto kërkime.

II

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në kallëzimin nr. 1395 prot. datë 19.04.2021 protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3985 prot., datë 19.04.2021, pretendohet se zj. Beruka ka shfrytëzuar postin e saj duke përdorur makinën dhe karburantin e shtetit për fushatë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 5723 prot., datë 10.06.2021, i ka kërkuar informacion Inspektorit të Përgjithshëm në lidhje me pretendimet e kallzuesit.

Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 677/4 prot., datë 15.06.2021, protokolluar me shkresën tonë nr. 5723/1 prot., datë 18.06.2021, ka informuar se nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se të gjitha automjetet e institucionit kanë lëvizur në zbatim të programit të inspektimit për periudhën janar-prill 2021, duke justifikuar të gjithë konsumin e karburantit.



III

Analiza ligjore

Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja “c” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, “veprimtari të ndaluara”, janë ato veprimtari që përfshijnë:

c) vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;

Lidhur me rastin objekt kallëzimi, kallëzuesi pretendon se zj. Beruka ka shfrytëzuar postin e saj duke përdorur makinën dhe karburantin e shtetit për fushatë në favor të Partisë Socialiste. Referuar nenit të mësipërm, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar në rast se do të kishim shfrytëzim të burimeve shtetërore për qëllime zgjedhore. Rezultoi e provuar gjatë hetimit administrativ se automjetet e institucionit ku zj. Beruka ushtron detyrën e saj, kanë lëvizur në zbatim të programit të inspektimit për periudhën janar-prill 2021 duke justifikuar të gjithë konsumin e karburantit. Komisioni i brendshëm hetimor i ngritur pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, pas verifikimeve të kryera, vërtetoi faktin e mësipërm.

Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se zj. Areti Beruka është në shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga kallëzuesi pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e këtij institucioni, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë



24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj zj. Areti Beruka, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Të shpall moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesave të tjera.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 18 Qershor 2021
Nr. 405

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Areti Beruka, me funksion Kryeinspektor i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë